



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Ligjshmërisë

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
PËRDORIMIN E PAJISJES SË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË VOTUESVE PËR
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Bazuar në nenit 20, pika 1, shkronjat “ë”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ose nga anëtarët e tij, për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit të domosdoshme për të siguruar përdorimin e ligjshëm, të rregullt, transparent, efikas dhe të qëndrueshëm të tyre.

II. PËRMBLEDHJE SHPIEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Referuar nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është përgjegjës për përcaktimin e zbatueshmërisë dhe drejton punën për zbatimin e projektit të identifikimit elektronik të votuesve. Ai bashkushtron me të drejta të barabarta me Komisionerin kompetencat për përzgjedhjen, monitorimin dhe zbatimin e teknologjisë për identifikimin elektronik të zgjedhësve.

Referuar nenit 22, pika 4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, sistemet ose pajisjet e teknologjisë së informacionit që KQZ-ja vendos të përdoren në zgjedhje duhet të synojnë, në radhë të parë, identifikimin elektronik të votuesve dhe verifikimin paszgjedhor të tyre, votimin me dhe nëpërmjet pajisjeve elektronike dhe numërimin nga pajisjet të votave të hedhura, si dhe të jenë të aplikueshme së paku për pesë procese zgjedhore të njëpasnjëshme.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së

Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon Komisionit Rregullator, që procesi i identifikimit elektronik të zgjedhësve, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) që janë përdorur në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, në të gjithë qendrat e votimit.

Madalena KOJA - Drejtorja e Ligjshmërisë

Aurel LAMÇE - Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: .4.2023

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**PËRDORIMIN E PAJISJES SË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË VOTUESVE PËR
ZGJEDHET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13864, datë 24.10.2022, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", nenit 14, pika 2, nenit 20, pika 1, shkronjat "ë", dhe nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

1. Në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, procesi i identifikimit elektronik të zgjedhësve të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) në të gjithë qendrat e votimit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar

Data:..2023 Nr:
Ora:



"Për përdorimin e pajisjes së identifikimit elektronik të votuesve për zgjedhjet për organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".